



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**Nr. i Dokumentit: 24.30.1-2017-08**

## **RAPORTI I AUDITIMIT**

**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AUTORITETIT  
RREGULLATIV TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE  
POSTARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

**Prishtinë, qershor 2018**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Valbon Bytyqi, i cili ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësja e ekipit, Selvete Foniqi dhe Anëtarët Shefkije Beka dhe Adelina Selmani, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Faruk Rrahmani.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	16
5 Qeverisja e mirë.....	17
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	19
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	22
Shtojca III: Letërkonfirmimi .....	25

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 11/04/2018.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare.

Zyra Kombëtare e Auditimit e vlerëson bashkëpunimin e treguar nga menaxhmenti i lartë dhe stafi i Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare gjatë procesit të auditimit.


### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore:****Përgjigja e Kryetarit të Bordit**

Kryetari i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP). Ne kemi analizuar veprimtarinë e ARKEP-it, se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

---

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

#### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa "Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare". Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

#### Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Bordit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e

---

pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ARKEP-it.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.



## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga ARKEP kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet tremujore duke përfshirë edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë; dhe
- Raportet për obligimet e papaguara.

Të gjitha kërkesat për raportim si në kontekst të PFV-ve ashtu edhe të raportimit të jashtëm ishin përmbushur dhe ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

### Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, realizimi i të hyrave, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet dhe të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithatë, një sërë fushash kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

Në vitin 2017, ARKEP kishte një performancë të kënaqshme sa i përket realizimit të shpenzimeve dhe të hyrave. Niveli i realizimit nga ajo që ishte planifikuar si të shpenzimet ashtu edhe të të hyrat sillet rreth 95%.

Fushat tjera ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë: tejkalimi i praktikës së menaxhimit të pozitive me ushtrues detyre përtej afateve të lejuara, pagesat e personelit nga kategoria e pagave dhe monitorimi dhe azhurnimi i rreziqeve. Po ashtu, sfidë mbetet edhe realizimi i projekteve kapitale të planifikuara.

### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>1</sup>	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>1,178,068</b>	<b>707,988</b>	<b>672,526</b>	<b>757,975</b>	<b>617,944</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,178,068	707,988	672,526	757,975	612,468
Donacionet e jashtme	-	-	-	-	5,476

<sup>1</sup> Buxheti final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga MF.

Me rishikim të buxhetit dhe me vendime të Qeverisë<sup>2</sup>, buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 470,080€. Ky zvogëlim ishte në investime kapitale 400,000€, në paga dhe mëditje 603€, si dhe në mallra e shërbime 69,477€.

Në vitin 2017, ARKEP ka shpenzuar 95% të buxhetit final ose 672,526€, që paraqet shpenzim më të ulët për 2% krahasuar me vitin 2016. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>1,178,068</b>	<b>707,988</b>	<b>672,526</b>	<b>757,975</b>	<b>617,944</b>
Pagat dhe Mëditjet	408,136	407,533	407,308	390,655	367,115
Mallrat dhe Shërbimet	357,232	282,555	248,639	290,715	239,836
Shërbimet komunale	12,700	17,900	16,579	10,098	10,993
Investimet Kapitale	400,000	-	-	66,507	-

Shpjegimet rreth shpenzimeve krahas buxhetit final në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti për paga e mëditje dhe shërbime komunale ishte në një nivel të kënaqshëm dhe nuk kemi ndonjë çështje për ta theksuar; dhe
- Buxheti për mallra dhe shërbime është shpenzuar 88%. Niveli i tillë i shpenzimeve në këtë kategori ishte edhe si rezultat që procedurat e prokurimit për ARKEP i kryen AQP dhe kishte vonesa në procedura dhe lidhje të kontratave nga ana e saj.

<sup>2</sup> Me vendimin e Qeverisë nr.08/151 të datës 02/08/2017, dhe vendimin nr. 10/19 të datës 15/12/2017, vendimin nr.01/21 të datës 22/12/2017 dhe vendimi nr.02/22 të datës 27/12/2017.

## Çështja 1 – Dobësi në procesin e planifikimeve për investime kapitale

**E gjetura** Realizimi i projektit kapital këtë vit ishte sfidë për ARKEP-in. Projekti “Sistemi menaxherial për bartshmëri të numrave” në vlerë prej 400,000€ sipas planit të prokurimit ishte paraparë të fillonte në muajin shkurt 2017. Ne verifikuam se kjo nuk kishte ndodhur pasi që nuk ishte iniciuar ndonjë kërkesë për fillimin e procedurave nga njësia kërkuese dhe fondet e këtij projekti janë reduktuar me vendim të qeverise në muajin gusht.

Projekti nuk ishte realizuar për shkakun që ARKEP nuk kishte bërë analizat e mirëfillta dhe parapërgatitjet e duhura për fillimin e projektit. Po ashtu, duhet theksuar faktin që në këtë projekt ishin të involvuar edhe akterë jashtë<sup>3</sup> ARKEP-it e që kjo mund të ketë ndikuar që projekti të mos realizohet gjatë vitit 2017.

**Rreziku** Planifikimi jo adekuat i projekteve rrezikon arritjen e objektivave të përcaktuara, dhe ndikon që financimi i këtyre projekteve të anulohet apo të mbetet barrë e buxheteve të ardhshme.

**Rekomandimi 1** Kryetari i Bordit duhet të siguroj se është bërë një vlerësim i shkaqeve në lidhje me pengesat e hasura në procesin e realizimit të projekteve kapitale, si dhe të nxjerrin mësimet në mënyrë që praktikat e tilla të mos përsëriten. Performanca e projekteve kapitale duhet të monitorohet në baza mujore dhe të adresohen barrierat e identifikuara me kohë, në realizimin e projekteve kapitale.

## 3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara gjatë vitit 2017 ishin 4,478,774€, që paraqet një realizim prej 95% nga ajo që ishte e planifikuar (vlera e parashikuar e të hyrave ishte 4,715,000€). Niveli i të hyrave ishte pak më i ulët se në vitin paraprak ku ishin arkëtuar 4,787,572€. Të hyrat kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, licencimin, të hyrat nga numeracioni dhe përdorimi i frekuencave, dhe pagesat për dënimet ekonomike të vendosura nga ARKEP.

**Tabela 3. Të hyrat e detajuara sipas llojit (në €)**

Përshkrimi	Realizimi 2017	Realizimi 2016	Realizimi 2015
Licenca për afarizëm	4,475,212	4,781,664	19,264,081
Taksa tjera administrative	2,870	3,473	2,880
Gjobat tjera	692	2,435	12,007
<b>Totali</b>	<b>4,478,774</b>	<b>4,787,572</b>	<b>19,278,968</b>

<sup>3</sup> Operatorët e Telefonive që operojnë në Kosovë.

Të hyrat e mbledhura nga ARKEP deponohen në Buxhetin e Kosovës.

### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe MF. Kontrollat që operojnë në nivel të ARKEP-it kanë të bëjnë me kontrollin e pagesave çdo muaj, verifikimin e ndryshimeve të mundshme, rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin.

Buxheti final në SIMFK për paga dhe mëditje ishte 407,533€, ndërsa shpenzimet ishin 407,308€ apo 99%. Ato kanë të bëjnë me pagat e Bordit drejtues, stafit profesional dhe administratën.

### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 3.4 Menaxhimi i personelit

Numri i aprovuar i të punësuarve në ARKEP ishte 39, ndërsa numri aktual në fund të vitit sipas PFV-ve ishte 38 punonjës, përfshirë edhe anëtarë të Bordit. Një pozitë e lirë për pozitën shef i departamentit ligjor ka mbet e lirë nga viti 2016.

### Çështja 2 - Angazhim për shërbime të veçanta pa procedura konkurruese

**E gjetura** Sipas Ligjit për Shërbimit Civil, neni 12 pika 4, kërkon që për kontrata për shërbime të veçanta të zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Në një rast ARKEP kishte angazhuar një asistente për gjashtë muaj, me kontratë për shërbime të veçanta pa zhvilluar procedura të thjeshtuara të rekrutimit. Përkundër që kontrata ishte për gjashtë muaj asistentja e angazhuar ka kërkuar ndërprerjen e kontratës pas katër muajve dhe kjo kontratë ishte ndërprerë.

**Rreziku** Angazhimi i stafit për shërbime të veçanta pa procedura të thjeshtësuar të rekrutimit kufizon konkurrencën dhe rritë rrezikun që angazhimi të bëhet në mënyrë jo transparente dhe si pasojë shërbimet e pranuar të mos jenë në përputhje me nevojat e ARKEP-it.

**Rekomandimi 2** Kryetari i Bordit duhet të siguroj se për angazhimin e stafit për shërbime të veçanta të jenë zhvilluar procedura të përzgjedhjes së tyre, në mënyrë që procesi të jetë transparent dhe të kenë mundësi të aplikojnë të gjithë ata që i plotësojnë kriteret.

### 3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunal, ishte 300,455€. Prej tyre ishin shpenzuar 265,218€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me: shpenzimet e qirasë, shpenzime për udhëtime zyrtare, dhe shpenzime kontraktuese tjera përfshirë edhe pagesën e një punonjësi/shofer dhe asistente që paguhen nga kjo kategori.

#### Çështja 3 - Pagesa për kontratë me afat të caktuar, nga mallrat dhe shërbimet

- E gjetura** Në ligjin e buxhetit 2017 te neni 3 pika 4, ceket se shpenzimi i parave publike nga kategoria “mallra dhe shërbime” nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të mëditjeve apo si kontribute në mall, përfshirë shujtat apo dhuratat. ARKEP prej vitit 2016 kishte të angazhuar një punonjës/voztës me kontratë për kohë të caktuar. Për vitin 2017 ky punonjës ishte paguar nga 465€/bruto për muaj nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.
- Rreziku** Kompenzimi i pagave për kontratë pune me afat të caktuar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ka ndikuar që të mbivlerësohet kjo kategori duke nënvlerësuar pagat dhe mëditjet.
- Rekomandimi 3** Kryetari i Bordit duhet të siguroj që kompensimet e punonjësve të bëhen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve.

### 3.6 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas PFV-ve dhe regjistrave kontabël vlera neto e pasurive kapitale ishte 455,345€, ndërsa vlera e pasurive jokapitale ishte 28,842€ dhe stoqet 12,135€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullës financiare Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit, zhvlerësimin dhe ekzistencën fizike të pasurive.

#### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.7 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme kanë të bëjnë kryesisht me obligimet e debitorëve lidhur me autorizimet për shfrytëzimin e frekuencave.

---

Në fund të vitit 2017 llogaritë e arkëtueshme ishin 1,128,477€. Pjesa më e madhe e tyre përkatësisht 864,701€ i takojnë vitit aktual dhe kanë mbetur të arkëtueshme nga fakti që faturimet e vitit 2017 bëhen në dhjetor ku operatorët pastaj kanë afat 30 ditë deri në kryerjen e obligimit. Pjesa tjetër prej 263,755€ e përbëjnë bilancet e bartura që nga viti 2010.

ARKEP, ka bërë përpjekje për mbledhjen e të arkëtueshmeve, duke iniciuar procedura gjyqësore pranë gjykatave kompetente, megjithatë ende mbetet sfidë realizimi i tyre. Posaçërisht sfidë mbetet arkëtimi i të arkëtueshmeve ndaj institucioneve publike siç janë MAP dhe RTK<sup>4</sup>, që e përbëjnë pjesën më të madhe të të arkëtueshmeve të vjetra.

#### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### **3.8 Obligimet e papaguara**

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 4,780€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018, të cilat kryesisht ishin obligim i vitit 2017, të faturuara në fillim të janarit 2018.

Detyrimet kontingjente ishin të shpalosura sipas PFV-ve në vlerë prej 15,355,486€, për të cilat zyra ligjore ishte në procese gjyqësore për mbrojtjen e këtyre lëndëve. Mbetet sfidë mbrojtja e tyre, pasi që humbja e tyre do shkaktonte detyrime me vlera mjaft të mëdha, që do të jenë të papërbalueshme të ekzekutohen nga buxheti i ARKEP-it. Ky rrezik mund të bie pastaj barrë e Buxhetit të Kosovës në të ardhmen.

#### **Rekomandimet**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

<sup>4</sup> Radio Televizioni i Kosovës

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e ARKEP-it për vitin 2016 ka rezultuar me tetë rekomandime. ARKEP kishte përgatitur me kohë një Plan Veprimi, ku kishte paraqitur detajet e masave dhe aktiviteteve se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Nga tetë rekomandimet e dhëna pesë ishin zbatuar dhe tri janë në proces. Vlen të theksohet se në kuadër të rekomandimeve që ishin në proces në brendi të tyre kishte pjesë të rekomandimeve që ishin zbatuar dhe pjesë të pazbatuara, andaj i kemi trajtuar si në proces.

Kurse raporti ynë i auditimit për vitin 2015 ka rezultuar me pesë rekomandime, prej të cilave tre rekomandime ishin bartur për tu zbatuar në 2017. Nga rekomandimet e vitit 2015, dy janë zbatuar dhe një është në proces e që ka të bëjë me miratimin e rregullores së punës.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

### Çështja 4 - Zbatimi i rekomandimeve nga dy vitet paraprake

<b>E gjetura</b>	Menaxhmenti ka bërë progres të theksuar në zbatimin e rekomandimeve nga vitet paraprake ku një pjesë e rekomandimeve tanimë janë zbatuar. Megjithatë mbeten ende disa fusha ku rekomandimet nuk janë zbatuar e që kanë të bëjnë me: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrimin e një funksioni (pozite) me UD nga viti 2016; dhe</li> <li>• Mos aprovimi i rregullores së punës.</li> </ul>
<b>Rreziku</b>	Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë me mos efikasitet të vazhdueshëm të kontroleve, dhe vështirësi në përmbushjen e objektivave.
<b>Rekomandimi 4</b>	Kryetari i Bordit duhet të rishikoj dhe analizoj shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor për zbatimin e rekomandimeve, përfshirë edhe stafin llogaridhënës. Procesi i zbatimit të rekomandimeve duhet të monitorohet në vazhdimësi.



---

## 5 Qeverisja e mirë

### Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

ARKEP ka marrë në konsideratë kërkesat ligjore të parapara me rregullat e MFK-së dhe ka përfunduar me kohë vetëvlerësimin, por ka nevojë për një vlerësim më kritik. Përmirësime kanë ndodhur me miratimin e Statutit të ARKEP-it me datë 28/08/2017.

Me gjithë progresin e realizuar në vlerësojmë që disa aspekte të qeverisjes brenda ARKEP-it kërkojnë përmirësim të mëtejshëm siç është miratimi i rregullores së punës. Ne verifikuam se ishte përgatitur regjistri i rreziqeve me të gjitha masat, duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj, si dhe ka zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve. Megjithatë nuk është bërë vlerësimi, monitorimi dhe azhurnimi i regjistrit të rreziqeve në periudha tremujore.

#### 5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Bazuar në U/A nr.23/2009 për themelimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, ARKEP nuk i plotëson kriteret për themelimin e kësaj njësie.

##### **Rekomandime**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

## 5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Procesi i raportimit të brendshëm në ARKEP funksionon sipas zingjirit llogaridhënës dhe sipas ligjit dhe strukturës organizative. Menaxhmenti ka vendosur linja të komunikimit dhe njoftohet përmes raportimeve mujore, për aktivitetet operacionale dhe financiare të organizatës, në disa raste takimet e Bordit përcillen me procesverbale.

Po ashtu, ekzistojnë edhe raportimet tremujore financiare, si dhe raportimet sipas kërkesave ligjore.

---

### Çështja 5 - Dobësi në menaxhimin e rrezikut

**E gjetura** Sipas rregullave të MFK-së, ARKEP ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut. Regjistri i rreziqeve ishte hartuar në muajin shkurt 2017.

Megjithatë, ne nuk kemi vërejtur se ai po menaxhohet dhe monitorohet në periudha tremujore për të parandaluar dhe zbutur rreziqet siç e kërkojnë rregullat e MFK-së.

**Rreziku** Mungesa e menaxhimit efektiv dhe gjithëpërfshirës të rrezikut do të pamundësojë reagimin me kohë ndaj rreziqeve me të cilat ballafaqohet institucioni, qofshin ato nga mjedisi i brendshëm apo i jashtëm. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar rreziqet e tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.

**Rekomandimi 5** Kryetari i Bordit duhet të siguroj monitorim efektiv dhe raportim tremujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë, me qëllim të parandalimit dhe zbutjes së rreziqeve.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së	Të sigurohet se është zbatuar një rishikim i listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe që është bërë adresimi i çështjeve të theksuara. Miratimi i statutit dhe rregullores se re të punës duhet të konsiderohet prioritet, po ashtu edhe ndryshimet në pozita të reflektohen në skemën organizative.		Është miratuar statuti, ndërsa mbetet sfidë miratimi i rregullores së punës.	
3.5 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Kërkesat për kompensimet e stafit në organizatë të përmbushen në përputhje me rregullat ligjore.	Po		
3.6 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	Softueri me të cilin bëhen llogaritjet në mënyrë automatike sa i përket frekuencave dhe dhënien e autorizimeve të funksionalizohet. Gjithashtu, programi për të hyrat duhet të funksionalizohet me qëllim të ruajtjes së informatave dhe raportimeve të sakta.	Po		
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim	Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Po		

2.3.1 Hartimi i rregulloreve të punës	Kryetari i Bordit duhet të analizojë arsyet e vonesave në përmbushjen e kërkesave ligjore për aprovimin e draft dokumenteve të brendshme dhe të sigurojë që deri më 1 tetor draftet e Statutit dhe Rregullores së brendshme të punës t'i paraqiten Bordit për aprovim.		Është miratuar statuti, ndërsa mbetet sfidë miratimi i rregullores së punës.	
3.1.1 Të hyrat	Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se regjistrimi i të hyrave në SIMFK bëhet në baza ditore pas pranimit të raporteve bankare në pajtim me Rregullën Financiare 03/2010 për të hyrat. Meqenëse të hyrat e mbledhura dedikohen për Buxhetin e Kosovës, atëherë regjistrimi i të hyrave në SIMFK duhet të bëhet në fondin burimor 10 – Buxheti i Kosovës.	Po		
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Kryetari i Bordit duhet t'i rishikojë kontrollet lidhur me rekrutimin e stafit dhe, sipas nevojës, t'i forcojë ato për të siguruar që rekrutimi bëhet përmes një procesi meritior dhe transparent në pajtim me kërkesat ligjore. Kriteret e punësimit duhet të jenë të qarta dhe të matshme për të siguruar trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët.		Edhe në këtë vit kishte kontratë për shërbime të veçanta pa procedura konkurruese.	
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se menaxhimi i personelit dhe pagesave bëhet në pajtim me procedurat dhe rregulloret relevante. Për pozitën e mbajtur me U.D. të bëhet një zgjidhje e qëndrueshme dhe në pajtim me kornizën ligjore.		Pozita e mbajtur me UD vazhdon të jetë edhe këtë vit. Deri në muajin prill ishin tri pagesa nga 40€ gjithsej 120€. Nga gjysma e dytë e vitit 2017 më nuk kishte asnjë pagesë prej 40€ për mbajtësen e procesverbaleve, si dhe është bërë azhurnimi i akt emërimeve.	

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari i Bordit duhet të sigurojë që shërbimet e telefonisë mobile të shfrytëzohen konform kërkesave ligjore të prokurimit publik për të përfituar shërbime më cilësore dhe më ekonomike. Të gjithë zyrtarët duhet të pranojnë mbushje brenda limiteve të përcaktuara me vendimet/rregulloret në fuqi.	Po		
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari i Bordit duhet t'i forcojë kontrollet e prokurimit dhe të shpenzimeve për të siguruar që lidhja e kontratave të bëhet vetëm pas zotimit të mjeteve dhe në pajtim me kërkesat tjera ligjore dhe udhëzuesit përkatës.	Po		
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se shfrytëzimi i automjeteve zyrtare bëhet në përputhje me kërkesat e rregullores së brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare. Për secilin automjet zyrtar të shfrytëzuar duhet të mbahet evidencë e plotë dhe e saktë.	Po		



## Shtojca III: Letërkonfirmimi



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

**Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit**

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

**Kreshnik Gashi, Kryetar i Bordit**



Data: 06 Qershor 2018, Prishtinë